“Betimi (në tregti) mundëson shitjen e produktit, por e zhduk bereqetin.”

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: “Betimi (në tregti) mundëson shitjen e produktit, por e zhduk bereqetin.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti në këtë hadith ka paralajmëruar kundër betimit dhe përsëritjes së tij të shpeshtë, edhe nëse njeriu është i sinqertë gjatë shitblerjes. Ai ka treguar se një gjë e tillë mund të ndihmojë në shitjen e mallit dhe në promovimin e tij, por në të vërtetë e pakëson dhe ia zhduk bereqetin fitimit. Allahu i Lartësuar mund ta shkatërrojë këtë pasuri në forma të ndryshme: përmes vjedhjes, zjarrit, fundosjes, konfiskimit, plaçkitjes ose në çfarëdo mënyre tjetër që e çon në humbjen e pasurisë së njeriut.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/5936